



Prishtinë, 30 qershor 2014
Kodi i ZRRE-së: V_638_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.6, Nenit 14, paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenit 25, Nenin 32 dhe Nenit 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe të tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së);
- Aplikacionin e KEDS të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Tetë të Tarifave të Energjisë Elektrike;
- Vendimin nr. V_635_2014 për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Furnizuesin Publik;
- Dispozitat e Nenin 4 dhe Nenin 9 të Licencës së OSSH-së;
- Dispozitat e Nenit 2.1 paragrafi 2.1.3; Nenin 4.2.1, Nenin 4.5.2 Nenin 4.8.4, Nenin 4.9.1, Nenin 4.10.1 Nenin 4.10.4 Nenit 4.10.7; Nenit 5.5.1 dhe 5.9.3 të Kodit të matjes;
- Dispozitat e Nenit 2.4.1 dhe 2.11.3 të Kodit të Shpërndarjes; si dhe
- Kërkesën e datës 26 qershor 2014 të KEDS-it dorëzuar ZRRE-së për miratimin e tarifave të rregulluara me pakicë.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, **në seancën e mbajtur më 30 qershor 2014 nxori këtë:**

VENDIM

- I. **APROVOHEN** tarifat dhe ngarkesat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar për vitin relevant tarifor SHTE8 që do të zbatohen nga i licencuari nga data 1 korrik 2014.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me datë 26 qershor 2014 ka pranuar nga KEDS kërkesën për shqyrtim të tarifave të rregulluara me pakicë;
- Për vendosjen e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen e saj si dhe takimet sqaruese që ka realizuar me të licencuarit gjatë periudhë shkurt-maj 2014. Këto dokumente janë:



- Raport Vlerësimin-Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara të Gjeneratorit të Rregulluar, i publikuar me datën 15 maj 2014;
- Raporti Përfundimtar- Kalkulimi i Kostos me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar me datën 24 qershor 2014;
- Raporti Përfundimtar- Kalkulimet e MAR-it të KOSTT SH.A, i publikuar me datën 24 qershor 2014;
- Raporti Përfundimtar- Kalkulimet e MAR-it të OSSH-së, i publikuar me datën 24 qershor 2014;
- Përgjigjet ndaj Komenteve të KEDS-it - Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara, i publikuar me datën 24 qershor 2014.
- Raporti përfundimtar -Kalkulimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Furnizuesit Publik me Energji Elektrike (FPEE), i publikuar më datën 24 qershor 2014.
- Përcaktuesit e faturimit të aprovuara nga ZRRE për vitin Relevant tarifar 2014-2015.

Gjatë caktimit final të tarifave me pakicë të energjisë elektrike, ZRRE-ja merr parasysh Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për të mbuluar kostot e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve të rregulluara si dhe konsumin e vlerësuar për secilën kategori tarifore përmes së cilave do të mbulohet MAR-i.

Raporti i tarifës së lartë ndaj tarifës së ulët qon drejt tarifës përfundimtare me pakicë (€/kWh). Në rolin e tyre prej Furnizuesi Publik, KEDS i dorëzon ZRRE-së – gjatë secilës Përshatje Vjetore – parashikimin e tyre të konsumit me energji elektrike për vitin relevant vijues. Përmes vlerësimet ZRRE-ja ka ardhur në përfundim se të dhënat e dorëzuara nga KEDS në fakt janë të dhëna të faturuara në vend të atyre të konsumit. Një njësi e energjisë elektrike mund të faturohet në një tarifë të ulët edhe pse e njëjta mund të jetë konsumuar në tarifë të lartë për shkak se njehsorët mund të mos jenë sinkronizuar me kohën reale - një situatë e cila kryesisht shkon në favor të konsumatorëve të amvisërisë me njehsorin elektrik mekanik.

Të dhënat e marra nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut sugjerojnë se energjia që hyn në shpërndarje mjaft shumë anon drejt tarifës së pikut (rreth 70% tarifë e lartë vs. 30% tarifë e ulët) ndërsa KEDS pret që ky raport të jetë pothuajse i barabartë (55% në tarifë të lartë vs. 45% në tarifë të ulët). KEDS-i do të duhej të ishte në gjendje që të arrijë nivel më të lartë të MAR-it me nivelin ekzistues të tarifave nëse janë në gjendje të faturojnë energjinë elektrike sipas kohës reale kur edhe ajo energji konsumohet.

Të dhënat për faturimin aktual të ofruara nga KEDS sugjerojnë se raporti i energjisë elektrike të faturuar sipas tarifës së lartë dhe asaj sipas tarifës së ulët nuk ka ndryshuar dukshëm gjatë 4 viteve të kaluara meqë pjesa e energjisë elektrike e faturuar me tarifë të lartë gjatë 2013 është vetëm 2% më e lartë se ajo në vitin 2010 (48% në 2013 kundrejt 46% në 2010).

Raporti i përgjithshëm i faturimit me tarifë të lartë prej 48% i arritur nga KEDS në vitin 2013 do të mund të ishte përmirësuar sikur të kishin arritur instalimin e 66,000 njehsorëve për të cilët kishin marrë Kthimin e Lejuar për MAR-in e 2013. KEDS ka treguar se në 2013 kanë instaluar rreth 50% të njehsorëve të rinj elektronikë. Prandaj, ZRRE-ja përmes vlerave të aprovuara të përcaktuesve të faturimit (68.5% në tarifë të lartë dhe 31.5% tarifë të ulët) do të duhej të rrisë nxitjet për KEDS-in që të instalojë njehsorët elektronik me qëllim që t'i shmanget problemeve me faturimin.



II. Duke marrë parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe shqyrtimin e të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Bordi i ZRRE-së nuk ka arritur në pajtueshmëri për ndryshimin e strukturës tarifore për këtë vit dhe vazhdon të mbetet e njëjta në fuqi.

Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, e cila do të zbatohet nga data 1 korrik 2014, përkatësisht në vitin Relevant tarifor SHTE8 është si në tabelën e mëposhtme:

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Të miratuara 2014	
					Sezona e lartë	Sezona e ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator
0-1	220kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		190.87	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		15.10	
		Energjia aktive (P)	€/kWh		2.33	
0-2	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		95.44	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		6.37	6.37
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.39	2.19
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.07	1.80
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.00	0.00		
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		12.62	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		6.62	6.62
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.73	3.35
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.09	3.01
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.75	0.75		
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		5.22	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.70	5.70
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	8.66	3.86
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.66	3.51
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.75	0.75		
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.94	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		3.31	3.31
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	9.62	5.34
			€/kWh	Tarifë e Ulët	6.06	5.04
Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.75	0.75		
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.33	
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifë e vetme	11.85	7.66
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	14.26	9.35
			€/kWh	Tarifë e Ulët	7.13	4.66
5	0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.37	
		Energjia aktive (P) për konsum:				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	5.28	3.80
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2.66	1.89
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.32	5.24
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.67	2.62
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	10.62	7.60
€/kWh	Tarifë e Ulët		5.30	3.82		
6	0.4kV matësi 1 tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.37	
		Energjia aktive (P) për konsum:				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e vetme	4.72	3.37
			€/kWh	Tarifë e vetme	6.53	4.66
>600 kWh/muaj (Blloku i tretë):	€/kWh	Tarifë e vetme	9.46	6.79		
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar:				
		<200 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		24.48	
		200-600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		44.31	
8	Ndriçim publik	>600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		74.66	
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.33	
		Energjia aktive (P) për konsum:	€/kWh	Tarifë e vetme	9.59	

Tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00 - 23:00 gjatë sezonit të ulët.

Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korrespondon me $\cos(\Phi)=0.95$



- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjeje midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar